# TRASHËGIMIA KULTURORE NË RAJONIN E BUJANOCIT, MALËSIA E BUJANOCIT

Vesel **SABEDINI**
Akademia “Rrënjët Tona”

**PËRMBLEDHJE**
Për të njohur kulturën e një populli duhet të njohim: gjuhën, adetet, zakonet, kostumet, monumentet, besimet etj. Tradicionalisht vlerat më të veçanta të kulturës shqiptare njihen si: mikpritja dhe besnikërija, mbajtja e fjalës apo besa e shqiptarit dhe besimet religjonet te shqiptarët.

***Fjalë kyçe:*** *malësi, zakone, kostume, besë, mikpritje.*

**ABSTRACT**
To know the culture of a people we must know: language, customs, customs, costumes, monuments, beliefs, etc. Traditionally, the most special values of the Albanian culture are known as: hospitality and loyalty, keeping the word or faith of the Albanians and the religious beliefs of the Albanians.

***Key words:*** *highland, mores, costumes, trust, welcome*

## MIKPRITJA DHE BESNIKERIA

Janë vlera të veçanta të kulturës shqiptare, ku dera e shqiptarit ka qenë gjithmonë e hapur dhe çdo kush që e kalonte pragun e shtëpisë, nderohej si mik i familjes. Sipas thënijes të njohur “bukë e kripë e zemër”.






***Fig. – 1*** *Foto te mikpritjes se kultures shqiptare*

## Mbajtja e fjalës së dhënë, besa e shqiptarit

Tradicionalisht shqiptarët janë shquar për atë që njihet si “Besa e shqiptarit”, mbajtja e fjalës së dhënë ka qenë nga institucionet më me vlerë të veçant te ne shqiptarët por edhe më gjërë. Besa është fjalë e dhënë për diçka të rëndësishme, premtim që jepet me dëshirë se do të mbahet. Besa shqiptarit ka qenë e njohur në mbarë Evropën dhe në shumë vende Aziatike, atë kohë kemi qenë të përmendur si popull i fjalës dhe premtim mbajtës.



*Fig.* – **2** *Shterngimi i duarve ne shenje bese*

**Trashëgimia kulturore në Rajonin e Bujanocit**

Rajoni i Bujanocit zë një vend të rëndësishme gjeografike kufizohet me Vrajën, Dardanën, Gjilanin, Preshevën dhe Tërgovishtën. Nëpër Bujanoc kalojnë: Autorruga Beograd-Nish-Vrajë-Preshevë-Shkup-Selanik dhe hekurulla Beograd-Shkup-Selanik.




***Fig.* – 3** *Rajoni i Bujanocit*

**Zbulimet arkiologjike në Rajonin e Bujanocit**

Janë të hershme qysh nga Koha e Vjetër Antike, të Mesjetës por edhe të Vonshmën e Kohes së Re, ku dëshmojnë për autoktonin e shqiptarëve në këto troje. Duke u bazuar edhe në librin e botuar nga autori Xhemaledin Salihu me titull Bujanoci i trashëgimis kulturore dhe natyrore.

Malësia e Bujanocit, dikur kishte 374 familje me 3112 banorë. Ajo kishte shkollën qendrore me 350 nxënës, ku kolektivi i asaj shkolle kishte mbi 40 punëtorë. Në këtë vendbanim të Malësisë, funksiononte tregu i kafshëve, tregu i gjelbër, 4 shitore, xhamia, ambulanca, ofiqaria dhe autobusi nga Bujanoci dhe Gjilani, qarkullonte tre herë në ditë. Po sot, pas vitit 1999, asgjë nuk funksionon, përveç një paralele e ndarë në Suharrën dhe në Zarbincë nën administrimin e shkollës së Muhocit. Sot, gjithashtu shumë familje janë larguar, e më të shumtë janë ata që po largohen dita ditës nga presioni i vazhdueshëm i shtetit e nga mungesa e gjërave elementare për jetës. Njëra nga



**Si trashëgimi kemi edhe ndërtimet e vjetra të banimeve si shtëpi të vjetra, oda etj**



**Shtëpia e vjetër e Riza Shabanit në Dobrosin,** sipas hulumtuesit dhe frazeologut nga Dobrosini, Halim Hasani, kjo shtëpi është më se 100 vjet e vjetër.

Ajo gjendet në koordinatat: me gjerësi gjeografike: 0552331, me gjatësi gjeografike: 469989.4, në lartësi mbideta



*Shtëpia e vjetër e Riza Shabanit në Dobrosin*

**Shtëpi e vjetër e Vesel Hasanit në Verban,** në koordinatat: me gjerësi gjeografike: 0555491, me gjatësi gjeografike: 469586.9, në lartësi mbidetare: 615 m.







**Shtëpi e vjetër e Mustafë Hysenit në Nasalcë,** gjendet në koordinatat: me gjerësi gjeografike: 422318.1, me gjatësi gjeografike: 214449.6, në lartësi mbidetare: 455 m.



Kjo shtëpi është ndërtuar më 1911.

**Shtëpi e vjetër e Haxhi Alisë në Samolicë.** Tashti pronë e familjes Mustafa, e ndërtuar në mbarim të shekullit XIX. Ajo gjendet në koordinatat: me gjerësi gjeografike: 422319.8, me gjatësi gjeografike: 214449.4, në lartësi mbidetare: 455 m.



**Si trashëgimi e kemi të njohur edhe Doganën e Vjetër në Davidovc i cili ishte objekt kufitar i vendosur në vitin 1878 pas Kongresit të Berlinit**



**Dogana e vjetër në Davidoc**

1. 10. Dogana e vjetër në Davidoc

Objekti kufitar Serbi-Turqi i vendosur më 1878,
Kongresit të Berlinit. Kjo ndërtesë shërbente edhe Dogan
Objekti gjendet në Davidoc, në koordinatat: me gjer
gjeografike: 422822.2, me gjatësi gjeografike: 214936.3,
lartësi mbidetare: 343 m.

164

***Fig.* – 4** *Dogana e vjeter ne Davidoc*

**Si trashëgimi kulturore e kemi të njohur Mullirin e fshatitë të ndërtuar para 200 viteve në Breznicë të Epërme**





***Fig.* – 5** *Foto nga Mulliri i fshatit ne Breznice te Eperme*



***Fig. - 6*** *Xhamia ne Zarbinc e rindertuar ne vitin 1889*

**Mejtepi ne Zarbince**

Mejtepi nga viti 1904 në kohën e P.Osmane, në fillim mësimi zhvillohej me shkronja të gjuhës arabe , nxënësit përgatiteshin për shkollim në Medresën e Shkupit dhe të Prishtinës.Në vitin 1945-46 , pas Luftës së Dytë Botërore filloi të punojë si shkollë shqipe deri në vitin 1981 shërbeu si shkollë qëndrore e Malësisë.Shpresoj që një ditë ky objekt i kujtimeve tona të rindërtohet dhe të shërbej si një muze që mos të harrohet e kaluara jonë ku mësuan të parët tanë.





Mejtepi që shërbeu si shkoll
tani po shkatërrohet

)bjekti ishte ndërtuar në vitin në vitin 1904

**lejtepin në Zarbincë,
ër nga rëndësia,
anorët e krahasojnë
ıe shtëpinë e Lidhjes
ë Prizrenit dhe atë
ë Alfabetit të Gjuhës
hqipe në Manastir**

Mejtepet kanë shërbyer për
shqiptarët si shkolla për
mësimin e shkrim-leximit
jip. Një i tillë gjendet ende në
atin Zarbincë, i cili pas 110
rsh ekzistencë rrezikon të
luket tërësisht. I ndërtuar në
n në vitin 1904, ky objekt
jtepi shërbeu pas luftës së Dytë
ërore si vatër arsimore për
ıorët e Malësisë së Bujanocit,
i në vitin 1981, kur u ndërtua
ëna e re shkollore në këtë fshat,
ır qendër e Bashkësisë Lokale
Suharnë, Novoselë dhe Priboc.
jimi i banorëve nga këto fshatra,
aku i dhunës dhe presionit serb,
në mëshirën e kohës edhe këtë
kt me vlera të veçanta kultur-

gjendjen e tij te autoritetet komu-
nale në Bujanoc. Kërkojnë që
mejtepi të meremetohet dhe të kat-
egorizohet në listën e monu-
menteve kulturo-historike të
Bujanocit. "Objekti ka vlera të
mëdha historike", thotë Belit
Hasani, banor i fshatit, tani me
banim në Gjilan.

**Në mejtep u mësua
shkrimi-leximi, u hoq ferexheja**

Për më tepër, ai nënvizon se
mejtepi i Zarbincës ka shumë
domethënie për Malësinë e
Bujanocit. Hasani e barazon atë për
nga rëndësia me shtëpinë e Lidhjes
Shqiptare të Prizrenit dhe me
shtëpinë e Alfabetit Shqip në
Manastir. "Zarbinca dhe Malësia e
Bujanocit nuk kanë objekt tjetër me
vlera më të mëdha se ky mejtep",
thotë Hasani. Dikur Zarbinca ishte
qendër arsimore jo vetëm e
Malësisë së Bujanocit, por edhe e
Gollakut në përgjithësi. Në këtë
ndërtesë u mbajtën takime të
rëndësishme edhe para dhe gjatë
Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së
Dytë Botërore. Në mejtepin e
Zarbincës u mbajtën takime, kon-
sulta, debate dhe u morën vendime

**Dikur Zarbinca ish
qendër arsimore j
vetëm e Malësisë
Bujanocit, por edh
Gollakut në
përgjithësi. Në kët
ndërtesë u mbajtë
takime të
rëndësishme edhe
para dhe gjatë Luft
së Parë Botërore d
Luftës së Dytë
Botërore**

përgjithësi nuk guxojnë ta lënë
shkatërrohet tërësisht një vlerë
kjo. Mejtepi duhet të vihet nën
mbrojtje ligjore të komunës së
Bujanocit. Ai është i vetmi objek
që ka mundur deri tani t'iu përb
lojë stuhive të të gjitha kohërav

***Fig. - 7*** *Mejtepi ne Zarbince*